

# NACIONAL

Gazeta e përditshme online:  
www.gazeta-nacional.com

Adresa: Ish-kinostudio "Shqipëria e re", Tiranë  
E-mail: nacionalalbania@yahoo.com, bucpapaj@yahoo.com

Poezitë e fundit të poetit Miliano Stefa përpara se të ndërronte jetë, 40 ditë më parë

## Në të dyzetat e mia

faqe 10-11




Leximi dhe interpretimi i letërsisë së Atë Anton Harapit

## "Andrra e Pretashit" dhe "Valë mbi valë"

Studim nga NDUE UKAJ

faqe 8



MTKRS dhe GKA shpallin konkursin për realizimin e 3 monumenteve

# Konkursi për shtatoren e Ismail Qemalit, Mbretit Zogu I dhe Hasan Prishtinës

faqe 16

## EDITORIAL

### "Sekretet e gazetarëve të RTSH-së"

Nga GUDAR BEQIRAJ,  
Kryetar i Akademisë së Shkencave

Eshtë kënaqësi për mua të marr fjalën i pari dhe të drejtoj promovimin e librit "Sekretet e gazetarëve të RTSH-së" të shkrimtarit dhe të publicistit të mirënjohur Albert Zholi. Në radhë të parë dua të vë në dukje se Zholi është një mik i afërt i Akademisë dhe Akademikëve, pasi ai është në çdo...




Faqe 15

### Orhan Pamuk dhe shikimi oriental i romaneve

Nga ARJAN TH. KALLÇO

Romancierë të pafajshëm dhe sentimentalë - është një libër i magjishëm për nga bardhësia dhe freskia. Edhe pse vetë Pamuku ka shkruar romane shumë të komplikuar dhe zotëron një kulturë të pafund, në këto leksione ai ruan gjendjen e djalit 15, 18 apo 20 vjeçar dhe për herë të parë...



Faqe 19

### ESKLUZIVISHT PËR GAZETËN "NACIONAL"

## Miss Florida, Stephanie Moore

Intervistoi:  
GJEKË MARINAJ



Letërsia streha ime e sigurt

## Në BRENDËSI

### Anoreksi

Poezi nga PETRAQ RISTO

faqe 9

### Poezi nga Libani

Përktheu: ANTON PAPLEKA

faqe 5

### Vizita e Hrushovit

Tregim nga URAN BUTKA

faqe 16

### U grindëm gjatë

Poezi nga MIRANDA HAXHIA

faqe 7

Prozë nga:  
TAHIR FONIQI, MERI LALAJ,  
SPIRO THOMARA, YLLI LAJÇI,  
SHERIF GASHI, GJON NEÇAJ

faqe 5,18,20

### "I çmenduri i pavionit 3"

Roman nga LEONARD VEIZI

faqe 17

Shefki Karadaku,  
një shkrimtar i harruar  
Nga HALIL RAMA, SAKIP CAMI

faqe 17

### Ankth figurash

Nga MIRANDA METE

faqe 14

### "Kam lindur bashkë me këngën"

Intervistë me këngëtarën GLORIA XHOMAQI

faqe 15,19



www.radionacional.al



Miss Florida 2001, Stephanie Moore (Stefani Murë), rrëfen ekskluzivisht për Nacional pasionin e saj për letërsinë

# Letërsia streha ime e sigurt

Intervistoi GJEKË MARINAJ

Pasi mori diplomën Bachelor dhe medalje nderi "summa cum laude" nga Universiteti North Florida në 2006-n, Stephanie Moore (Stefani Murë), e lindur dhe rritur si floridiane, provoi shansin në shtetin e Teksasit, për të ndjekur pasionin e saj për letërsinë. Stephanie e filloi karrierën e saj të oratorisë dhe të shkruarit, pas marrjes së titullit Miss Florida Right to Life në vitin 2001, gjë që i dha asaj një platformë për të folur më sipërme shtetit, në temën specifike të interesit, të fuqizimit dhe edukimit për gratë e reja. Stephanie përfaqësoi gjithashtu shtetin e Floridës në garën Kombëtare të Oratorisë "National Right to Life Oratory Contest", në Qershor 2001. Për më tepër, ajo mori njohje më të madhe në mars 2002, duke fituar Çmimin për "Dëshmia më e mirë", në garën Gjykim Mock të Shtetit të Floridës. Arritje të tjera profesionale përfshijnë zgjedhjen e saj nga Universiteti North Florida për të folur në emër të kolegëve të saj shkollare, në emër të shoqatës së nderit Sigma Theta Tau Honor Society. Aktualisht, Stephanie jeton në Dallas, Texas, ku ka marrë një pozicion të lartë me shkrimet e saj. Ajo vazhdon të ndjekë pasionin e saj për poezinë dhe shpreson gjithashtu se një ditë do të ofrojë nëpërmjet shkrimit, redaktimit dhe intervistimit, trajtimin e historive me interes njerëzor. Qëllimi i saj është, që ajo një ditë të publikojë një roman me objektiv gratë, duke dhënë frymëzim përmes humorit shpresëdhënës dhe shembuj realë të jetës së vërtetë, mbi rëndësinë e të mbeturit i paprekur në vetëdijen tuaj.

**Gjekë Marinaj: A mendoni se shkrimi juaj ka mundësi të kapërcejë kultura të ndryshme, fe apo mjedise shoqërore të larmishme? Nëse po, çfarë shpresoni të merrni apo fitoni nga kultura shqiptare?**

Stephanie Moore: Unë mendoj se është e mundur ta përdor shkrimin tim për të krijuar një mesazh universal për të gjithë ata që do të ndeshen me të. Besoj se nuk ka rëndësi raca, feja, kredoja, edukimi, statusi social apo pozicioni në shoqëri - duhet të ketë një mesazh universal, që ka kuptim për të gjithë.

Mendoj se shkrimi është një mjet i fuqishëm. Unë mund të mos flas të njëjtën gjuhë si bashkëmoshatarët e mi nëpër botë, mund të mos jem rritur me të njëjtat vlera, apo mund të mos i lutem të njëjtit Zot - por jam e sigurt se ka disa tendenca instinktive njerëzore që i kapërcejnë të gjitha. Një buzëqeshje mund të përcjellë të njëjtin mesazh në çdo rrethanë, dhe fjalët - ato mund të shërojnë një shpirt - kur ndërtohen me pastërti hyjnore dhe qëllim të drejtë. Ndonëse historia ime mund të jetë me humor, inkurajuese, që ta copëton zemrën, dëshpëruese, e ndershme apo e përlurur - besoj se zëri dhe toni pas fjalëve të mia do të kuptohet. Besoj gjithashtu se kur udhëhiqesh nga mirësia dhe përlësia e vërtetë, ka mundësi të pafundme që të presin. Shpresoj që fjalët e mia t'i shërojnë të tjerët, ashtu si fjalët e të tjerëve më kanë shëruar mua. Shpresoj se mund ta ndaj fuqinë që më kanë dhënë historitë më të fuqishme. Dhe shpresoj se mund të çelë aq shumë buzëqeshje, nga aq shumë fytyra e vende, sa ç'ka edhe fjalët për të shkruar. Kjo është lutja ime. Këtu unë do të gjej paqen time.

Shqipëria për mua përfaqëson atë, se sa të fuqishme mund të jenë në të vërtetë këmbëngulja dhe lëvizja. Vendi, njerëzit dhe historitë - të gjitha këto për mua tregojnë se pse është kaq e rëndësishme për t'u shtyrë përpara drejt madhësisë. Bukuria e relievit është një testament i krijimit të më të mirës. Historitë e krijimit të vëllazërisë janë të admirueshme. Njerëzit që kanë lindur atje dhe kanë ndarë më vonë madhësinë e tyre si udhëheqës të mëdhenj, meritojnë mirënjohjen e botës. Unë nuk pyes se çfarë mund t'i jap këtij vendi - sepse do të zbehte krahasimin me atë, që edhe historitë më të thjeshta më kanë dhënë mua - dhe kjo do të thjeshtëzonte shpresën. Në këtë mënyrë, shpresa ime tani qëndron në faktin, nëse do të jem në gjendje të udhëtoj në këtë vend të mrekullueshëm, për të thithur çfarëdo që të mundem nga ajo, që mendoj se është kuptimi i vërtetë i bukurisë.



Stephanie  
Moore

**GJM: Tani që ju po hyni seriozisht në botën e të shkruarit, a besoni akoma në konceptin e rrezikut të llogaritit dhe çfarë do të thotë kjo për ju?**

SM: Nuk ka shpërblim më të madh, që unë mund t'i jap vetes, se rritja. Unë kam mësuar nëpërmjet provës dhe gabimeve të shumta që kam mbjellë në një vend, ku shpirti është shtrirë në të gjithë kapacitetin e vet. Jam në lëvizje të vazhdueshme, gjithnjë duke mësuar, gjithnjë duke u rritur. Kam lindur për të kërkuar dhe për të mbledhur.

Duke thënë këtë, unë nuk kam qenë e bekuar me një lindje nga mirëbesimi. Rrethanat e jetës kanë sfiduar shumë herë vlerat e mia, po t'i llogarisësh. Kam rënë në fund ndonjëherë dhe pastaj jam rritur e përshtatur, madje edhe me shtresën poshtë zhavorrit. Mjafton të them, nuk ka qenë e lehtë. Megjithatë, kam mësuar disa të ngul këmbë. Kam mësuar se kur shkund pluhurin nga lekat, është një masë e tërë shprese, që mund të ngrihet nga përvoja jote, nëse ju vazhdoni të lëvizni.

Marrja e një vendimi të llogaritit për të ndarë shkrimet e mia, peshon ndjeshëm në zemrën time për mjaft kohë, sepse është diçka, që unë nuk e kam bërë më parë. Të qenit një person që lulëzon në përputhje me rregullat dhe marrin kontroll nga rutina e rregullorja, është ndoshta përpjekja më e frikshme që kam ndjekur ndonjëherë. Shkrimi im,

është zbrazja e shpirtit tim në letër. Është një zgjerim natyral i vetes sime. Kështu që, vendimi për t'i ndarë këto me të tjerët, duke ditur që ka edhe kritikë, të bën të ndihesh e panjohur dhe e frikësuar. Por, mjaft çuditshëm, ndihesh edhe e çliuar.

Unë besoj në këtë rrezik, sepse shpërblimi nuk ushqehet nga mburrja, egoja, popullariteti, apo pasuritë e jashtme. Kjo drejtohet nga fakti, se unë e di që nuk ka mënyrë tjetër për t'u rritur, e cila s'është e pamundimshme. Dhe shpirti im ka nevojë të shtrihet.

**GJM: Pse të shkruarit është diçka kaq e rëndësishme për ju?**

SM: Nuk e di nëse ka ndonjë reflektim më të ndershëm nga vetja ime, sesa kur shkruaj. Kjo bën një çlirim purgativ të çdo gjëje thelbësore që vjen direkt nga shpirti. Unë nuk e fshih atë që mendoj se tingëllon e përshtatshme për t'u thënë, apo atë që do të kënaqte veshin e tjetrit. Thjeshtë vendos fjalët në një mënyrë që është kuptimplote dhe e qëllimite për mua. Është pasqyrë terapeutike për më të mirën.

Shkrimi është i rëndësishëm për mua, sepse e thënë thjeshtë; fjalët mbartin peshë. Shpërndarja dhe qëllimi pas çdonjërit që shkruan, mbart një sasi force të rëndësishme dhe prekëse. Fjalët kanë aftësi të jenë shkatërruese dhe të dëmshme, ashtu

siç edhe mund të rindërtojnë dhe rikonstrukturojnë shpresën për audiencën e tyre.

Gjatë rritjes, mua më mungoi sistemi bazë, që mëson dhe forcon një fëmijë. Nuk kisha burime për të krijuar imazhin e një marrëdhënie të shëndetshme, apo përgjigje për pyetjet e thjeshta të jetës. E mësova shpejt se, nëse do të kisha nevojë të mësoja për të ditur më mirë, për të qenë më e mirë dhe për të bërë më mirë në këtë jetë, do të kisha nevojë edhe për ndihmën dhe mençurinë e të tjerëve. Kjo erdhi tek unë përmes formës së të lexuarit. Librat u bënë streha ime e sigurt - autorët, mësuesit e mi të jetës. Sa më shumë kohë shpenzoja duke lexuar përvojat e të tjerëve, fillova të ndihesha më pak e izoluar dhe më shumë pjesë e një komuniteti. Nuk isha vetëm.

Prandaj, të shkruarit ka një qëllim të veçantë për mua, sepse, nëse fjalët e mia, vetëm një herë, mund ta ndihmojnë dikë që të fitojë autonomi, vlera për veten, vlerësime apo vlera tjera - unë do ta kem para-paguar atë.

**GJM: Si mund të kontribuojë pena juaj në rëndësinë dhe vlerat e bukurisë fizike, në këtë planet të larmishëm?**

SM: Ka diçka që më pëlqen ta quaj "fuqia e bukurisë". Është aftësia për ta përdorur bukurinë fizike si katalizator. Është e provuar nga pikëpamja sociale, dhe për mua, kjo e bën marrjen dhe ruajtjen e vetë-vlerësimit shumë më të vështirë. Shoqëria jonë e ka vënë theksin kaq shumë në atë çfarë konsiderohet stereotipikisht e bukur. Kjo ndodhet kudo. Që nga magjia e marketingut, tek premisat e realitetit televiziv - njerëzit simpatikë sundojnë botën.

Nuk po them se jam e imunizuar nga kjo. Edhe unë jepem pas shumë trukeve "për të humbur peshën dhe për t'u ndier madhështor", kur në fund të fundit, më pëlqen një petull e ëmbël. Tani do të përulesha para komplimentit të dikujt, po të më thoshte se jam e bukur, sepse për mua, këtu ka më tepër se rimeli im.

Të shkruarit heq paragjykimet. Të lejon për një pllakë të pastër të një gjykimi të padëguar. Fjalët nuk tregojnë racë, fe apo besim. Dhe natyrisht ato nuk duan t'ia dinë për një numër në shkallë, kush vishet më mirë, apo nëse rrenjë e tua kanë nevojë për t'u ri-theksuar. Ato tregojnë perspektiva dhe histori botërore apo individuale. Ato tregojnë rrëfenja nga të cilat çdo person mund të marrë informacion, të cilin mund ta plotësojë ose shpërfillë. Të shkruarit i jep autorit një bord kumbues. Pavarësisht se audiencia mund të përbëhet nga një, apo nga një numër i pafundëm i lexuesve të zellshëm. Tregimi i historisë tënde pastaj bëhet rreth eksperiencës, që doni të komunikoni, dhe jo rreth teje.

Besoj se është një emërues i përbashkët për të gjithë njerëzimin - dhe kjo është njohja. Për mua është bërë krejtësisht e qartë, që në një marrëdhënie, qoftë miqësore apo e kundërta, çdo person në këtë planet kërkon thjeshtë të dëgjohet. Ata thjeshtë duan të dinë - a jam i vlefshëm?

Objekti im është që të përdor fuqinë e penës time për të provuar pikërisht këtë. Çdo person është i vlefshëm. Çdo jetë ia vlen të njihet. Çdo person ka nevojë për një dëshmi dhe çdokush ka nevojë të vërehet, të bjerë në sy. Edhe nëse ata janë pa grim dhe në veshje sportive.

**GJM: Imagjinoni veten tuaj në ndenjësën e shoferit të një makine kohe. Cili do të ishte destinacioni juaj i parë: e shkuara, e tashmja apo e ardhmja? Pse?**

SM: Besoj se politikisht, përgjigjja më e saktë për këtë pyetje do të ishte të qëndroja në të tashmen. Në fund të fundit, të gjithë e kemi dëgjuar shprehjen "e shkuara është histori, e ardhmja është mister, dhe e sotmja është një dhuratë - prandaj quhet e tashme".

Por unë nuk jam e interesuar për të qenë politikisht korrekte, apo për dhuratat. Unë do të vizitoja të shkuarën, megjithëse, specifikisht si vëzhgues. Për të thënë të vërtetën, e shkuara ime është një koleksion i momenteve me ngjyra dhe i një vetmie vetmitare. E kam urryer reflektimin tim. Kam dashuruar çfarë kam parë. Kam qenë ziliqare, guximtare, e shkathët, kurajoze, e lodhur, en-

